



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 387, Datë 28.12.2023**

**MBI**

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ALPIQ ENERGY ALBANIA” SH.P.K. PËR HEQJEN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, gërma “dh” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, gërma “dh”, 7, paragrafi 2 dhe nenit 9, gërma “d” të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikës 5.1, gërma “dh” të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1450/3prot., datë 22.12.2023, të përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi kërkesën e shoqërisë “ALPIQ ENERGY ALBANIA” sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe heqjen e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ALPIQ ENERGY ALBANIA” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 290, seria T15/T20, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.05.2015, rinovuar me vendimin nr. 81, datë 04.05.2020, për një afat 5-vjeçar (deri më 04.05.2025).
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 341, datë 14.11.2023, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e kësaj licence, për arsye se shoqëria nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2023 dhe nuk kishte depozituar asnjë dokument apo argument në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.
- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim me shkresën nr. 1450/2 prot., datë 21.11.2023, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2500 prot., datë 13.12.2023, shoqëria ka paraqitur kërkesën për heqjen e kësaj licence, pasi ka vendosur mbylljen e veprimtarisë dhe nisjen e procedurave të likuidimit, duke marrë angazhimin për të shlyer sa më shpejt pagesën rregullatore.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare (statement) të ERE-s rezulton se kjo debi është shlyer në datën 14.12.2023, ndaj ajo nuk rezulton më debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit.
- Në nenin 42, pika 1, gërma “dh”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, në nenin 5, gërma “dh” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, si dhe pikën 5.1, gërma “dh” të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016, përcaktohet se: *ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit.*
- Në nenin 7, paragrafi 2 i Rregullores së sipërcituar përcaktohet se: *Në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje, ndërsa në nenin 9, germa “d” të kësaj rregulloreje parashikohet se ...Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat "dh" dhe / ose "e" të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.*
- Duke qenë se tashmë ndryshojnë rrethanat/shkaqet për të cilat u mor vendimi i bordit nr. 342/2023, vlerësohet të vijohet me procedurën e heqjes së licencës së shoqërisë “ALPIQ ENERGY ALBANIA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, por duke miratuar kërkesën e saj për heqjen e kësaj licence, sipas përcaktimeve ligjore si më lart cituar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “ALPIQ ENERGY ALBANIA” sh.p.k. për heqjen e licencës nr. 290, seria T15/T20, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “ALPIQ ENERGY ALBANIA” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.05.2015, rinovuar me vendimin nr. 81, datë 04.05.2020.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar e humbet fuqinë juridike.
3. Grupi i Punës të njoftojë shoqërinë “ALPIQ ENERGY ALBANIA” sh.p.k dhe shoqërinë “Operatori Sistemit të Transmetimit” sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**